

Prokurorisë Themelore në Prishtinë

Nga: Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), përfaqësuar nga Drejtoresha Ekzekutive znj. Arbëresha Loxha;

Balkan Green Foundation Prishtina (BGF), përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv z. Visar Azemi.

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv z. Burim Ejupi;

Instituti për Studime të Avancuara (GAP), përfaqësuar nga Drejtoresha Ekzekutive znj. Nora Latifi;

Për: Prokurorinë Themelore në Prishtinë

Data: 31 janar 2020

Lënda: Kallëzim penal ndaj z.Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)

GLPS duke u mbështetur në nenin 414 dhe nenin 323 të Kodit Nr. 06/0L-074 të Penal të Republikës së Kosovës (KPK), paraqet këtë:

KALLËZIM PENAL

Për veprat penale të:

- **“Lejimi i kundërligjshëm i ndërtimit apo drejtimit të fabrikave dhe instalimeve që ndotin mjedisin”**e paraparë në Nenin 340,par.1, lidhur me nenin 28, par. 1 të KPK;
- **“Mashtrimi”** nga nenin 323 I KPK-së;
- **“Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”** nga neni 414 i KPK-së.

Hyrje

- I. Vendimi i parë i Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës, ndaj kërkesës së z. Rrahman Haradini nga Medvegja**

1. Me datë 05.09.2017 në Drejtorinë e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës, z. Rrahman Haradini nga Medvegja ka parashtruar kërkesë me nr. 05-350/02-0222986/17, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e kompleksit të shtëpive individuale të banimit, në kuadër të parcelave kadastrale nr. 574-2, nr. 574-3, nr. 578-4, nr. 603-2, nr. 603-3, nr. 603-4 dhe nr. 603- 6 e evidentuar ne çertifikatën e njësisë kadastrale nr. P- 71914032-00574-2, P- 71914032-00574-3, P- 71914032-00578-4, P- 71914032-00603-2, P- 71914032-00603-3, P- 71914032-00603-4 dhe P- 71914032-00603-6 ZK Zllatar, në Prishtinë.
2. Me datë 15.05.2018, Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës ka marrë vendim refuzues lidhur me kërkesën me nr. 05-350/02-0222986/17, të paraqitur nga z. Rrahim Haradini me arsyetimin se duke u bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga z. Rrahim Haradini, parcelat për të cilat i njejt i kërkuar të i lëshohen kushtet e ndërtimit janë të përfshira në Zonën II, ku sipas Vendimit me nr. 16/127 të Qeverisë së Kosovës, ndalohet ndërtimi i objekteve për turizëm, rekreacion si dhe objekteve të tjera të cilat mund të rrezikojnë cilësinë e ujit.
3. Në këtë aspekt vlen të përmendet që gjatë trajtimit të kësaj kërkesë, Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës ka konstatuar se zona në fjalë është e mbuluar nga Plani Zhvillimor Komunal sipas të cilit disa prej parcelave të paraqitura në dokumentacionin e z. Rrahim Haradini janë paraparë për ndërtim dhe sipas Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Lindje” sipas të cilës kjo zonë është paraparë për gjelbërim; plane këto që nuk janë në përputhje me njëra tjetrën. Me këtë rast i është drejtuar sektorit ligjor për udhëzim për veprim se me cilin plan duhet të vazhdoj trajtimin e kërkesës dhe përgjigjja nga ky sektor ka qenë që mirret parasysh Plani Zhvillimor Komunal (PZhK). Mirëpo, meqenësese zona për të cilën janë kërkuar të lëshohen kushtet e ndërtimit gjindet afër liqenit të Badovcit, Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës ka konsultuar edhe Vendimin me nr. 16/127 të Qeverisë së Kosovës, të datës 24.04.2013, për caktimin e zonave të mbrojtura dhe masat mbrojtëse të burimit ujor sipërfaqësor- akumulimi i Badovcit. Dhe bazuar në këtë vendim, Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës ka konstatuar se parcelat kadastrale nr. 574-2, nr. 574-3, nr. 578-2, nr. 603-2, nr. 603-3, nr. 603-4 dhe nr. 603- 6 ZK Zllatar, për të cilat janë kërkuar të lëshohen kushtet ndërtimore për ndërtimin e kompleksit të shtëpive individuale të banimit, janë të përfshira në Zonen II, ku sipas pikës 4.3 ndalohet ndërtimi i objekteve për turizëm, ose rekreacion, dhe objekteve tjera të cilat mund të rrezikojnë cilësinë e ujit. Prandaj, Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës ka konstatuar që nuk mund të lëshohen kushtet e ndërtimit për zonën në fjalë dhe ka refuzuar kërkesën e z. Rrahim Haradini.

4. Rrjedhimisht, Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës si dokument me peshë më të lartë juridike ka konsideruar Vendimin me nr. 16/127 të Qeverisë së Kosovës, të datës 24.04.2013, për caktimin e zonave të mbrojtura dhe masat mbrojtëse të burimit ujor sipërfaqësor- akumulimi i Badovcit dhe jo Planin Zhvillimor Komunal. Kjo meqenëse çfarëdo plani zhvillimor, si në rastin konkret “Plani Zhvillimor Komunal”, i datës 03.01.2017, i cili nuk është në përputhje me vendimin e qeverisë i cili në këtë rast ka fuqinë e *lex specialis*, meqenëse rregullon një zonë të caktuar e të veçantë dhe jo një zonë e cila përfshinë territor me të gjerë si rasti i Planit Zhvillimor Komunal, nuk mirret për bazë. Kjo për shkak që së pari, vendimi i qeverisë është krijuar pikërisht për mbrojtjen e asaj zone nga çfarëdo ndërtimi që do të mund të parashihej me çfarëdo Planin Zhvillimor Komunal; së dyti, Plani Zhvillimor Komunal nuk është në përputhje me vendimin e qeverisë andaj dhe i njëjti nuk duhet marrë si bazë për çfarëdo veprimi në një zonë që është e mbrojtur dhe së treti, vendimi i qeverisë ka peshë më të rëndë e të lartë juridike se Plani Zhvillimor Komunal.

II. Vendimi i parë i MMPH-së ndaj ankesës së z. Rrahim Haradini ndaj Vendimit të Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës

5. Me datë 08.08.2018, Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka vendosur në kuadër të ankesës së paraqitur nga z.Rrahim Haradini kundër vendimit refuzues të datës 15.05.2018, të Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës, duke aprovuar ankësen e tij dhe duke anuluar këtë vendim. Për më tepër, Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së ka obliguar Drejtorinë e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës që të administroi këtë çështje nga fillimi. Këtë vendim Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së e bazoi në tre argumente si mëposhtë.
6. Së pari, arsyetimi i vendimit të datës 08.08.2018, të Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së mbështetet në faktin se Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës nuk ka vendosur drejtë lidhur me kërkesën e Z. Rrahim Haradini sepse nuk ka zhvilluar procedurën e aplikimit për kushtet ndërtimore konform nenit 11, paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ MMPH nr. 06/2017 për Përcaktimin e Procedurave për Përgatitjen dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushtet Ndërtimore dhe Leje Ndërtimore dhe Leje Rrërimi për Kategorinë e I-rë dhe të II-të të Ndërtimeve, pasi në dosje mungon Pëlqimi Mjedisor i cili nuk është kërkuar nga pala si kërkesë për vlerësim të ndikimit në mjedis, në procedurë të aplikimit pasi në shtojcën I është paraparë të plotësohet edhe kushti “nëse shfrytëzimi i propozuar nga aplikuesi a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë”. Së dyti, Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së konstaton që Drejtoria e Urbanizmit

në Komunën e Prishtinës nuk e ka shqyrtuar dhe aplikuar në tërësi Vendimin me nr. 16/127 të Qeverisë së Kosovës, por ka vepruar duke anashkaluar nenin 7, nenin 13 paragrafi 8 dhe nenin 15 të tij, i cili u jep mundësi investitorëve të marrin Pëlqimin Mjedisor konform ligjit në fuqi në realizimin e ndonjë ndërtimi apo projekti të projekti të planifikuar. Së treti, Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së vendimin e saj e bazoi edhe në dispozitat e nenit 20 paragrafi 3 nënparagrafi 3.5 të Ligjit nr.04/L-110 për Ndërtim, nenin 36, 37 të Udhëzimit Administrativ 15/2017 për Kriteret për përcaktimin e zonave të mbrojtura sanitare të burimeve të ujit. Rrjedhimisht, Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së obligoi Drejtorinë e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës që të trajtoj lëndën nga fillimi, konform nenit 20 paragrafi 3 nënparagrafi 3.5 dhe neni 21 të Ligjit nr.04/L-110 për Ndërtim dhe MMPH nr. 06/2017 për Përcaktimin e Procedurave për Përgatitjen dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushtet Ndërtimore dhe Leje Ndërtimore dhe Leje Rrërimi për katëgorinë I-rë dhe II-të të Ndërtimeve.

7. Rrjedhimisht, baza e vendimit të Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së i cili aprovon ankesën ndaj vendimit të Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës është në faktin që Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës e ka refuzuar kërkesën për lëshimin e kushteve ndërtimore të paraqitur nga z. Rrahim Haradini duke u thirrur në Vendimin e Qeverisë nr. 16/127 në tërësi dhe duke mos u lëshuar në procedurat përkatëse që aplikohen në rastet kur kemi kërkesa që hyjnë në fushëveprimtarinë e këtij vendimit. Pra, sipas Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës do të duhej të zbatonte procedurën e cila aplikohet në rastet e kërkesave të tilla që kanë të bëjnë me zona të mbrojtura nga vendime të qeverisë e që kërkojnë implikim të MMPH-së përmes aprovimit apo refuzimit të kërkesës për Pëlqim Mjedisor, akt që lëshohet nga MMPH-ja. Pra, Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së ka kërkuar që Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës të mos vendos duke u thirrur në Vendimin e Qeverisë nr. 16/127 por ka kërkuar që ky institucion të filloj procedurat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe rrjedhimisht ta lejoj MMPH-në të vendos në kuadër të Vendimit të Qeverisë.

III. Vendimi i dytë i Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës, ndaj kërkesës së z. Rahman Haradini nga Medvegja, pas vendimit të parë të MMPH-së

8. Me datë 28.02.2019, gjatë rishqyrtimit të lëndës në procedurë administrative sipas vendimi me datë 08.08.2018 të Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës për herë të dytë me rradhë mori vendim për refuzim të kërkesës së z. Rahman Haradini nga Medvegja, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e kompleksit të

shtëpive individuale të banimit, në kuadër të parcelave kadastrale nr. 574-2, nr. 574-3, nr. 578-4, nr. 603-2, nr. 603-3, nr. 603-4 dhe nr. 603- 6 e evidentuar ne çertifikatën e njësisë kadastrale nr. P- 71914032-00574-2, P- 71914032-00574-3, P- 71914032-00578-4, P- 71914032-00603-2, P- 71914032-00603-3, P- 71914032-00603-4 dhe P- 71914032-00603-6 ZK Zllatar, në Prishtinë. Këtë vendim, Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës e bazoi në argumentet si mëposhtë.

9. Së pari, sipas Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës, Planit Zhvillimor Komunal (PZhK) përfshin një plan për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale dhe prandaj PZhK-ja është dokument udhëzues për zhvillimin e gjithë territorit. Planit Zhvillimor Urban (PZhU) në hartim do të përcaktoj kushtet e zhvillimit urban për zonat urbane dhe planet rregulluese urbane do t'i përcaktojë kushtet për hapësirën rregulluese si dhe rregullat për vendndodhjen e banesave në tokën e zonës urbane. Për çdo plan hapësinor që shtrihet në një sipërfaqe më të madhe se 2 ha jashtë zonës urbane duhet të hartohen plane rregulluese. Bazuar në këto të dhëna dhe dokumentacionin e prezantuar – konkretisht zgjidhjes urbane për caktimin e kushteve ndërtimore për ndërtimin e kompleksit të shtëpive individuale të banimit, përfshihet sipërfaqja prej 26 000 m² (sipërfaqe që kalon sipërfaqen prej 2ha), dhe pasiqë lokacioni – zona për të cilën kërkohet caktimi i kushteve ndërtimore për ndërtimin e kompleksit të shtëpive individuale të banimit, shtrihet në kuadër të Planit Rregullues “Prishtina e Re, Zona Lindje” i miratuar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës me Vendimin 01 nr. 034-186833, me datë 02.10.2013, dhe sipas këtij plani kjo zonë është paraparë të jetë zonë e gjelbërt, konkretisht i miratuar pas PZhK, me Vendimin 01 nr. 031-156871, me datë 27.07.2013. Bazuar në këto faktë, Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës ka konstatuar se dokumentet ekzistuese të planifikimit hapësinor, të cilat janë të miratuara mbeten në fuqi derisa të harmonizohen me dispozitat e Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 04/L-174, të datës 31.07.2013 apo deri në hartimin e Hartës Zonale, apo Planit Rregullues të Hollësishëm.
10. Së dyti, Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës argumenton se Vendimin për përcaktimin e mënyrës së zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor në zonat urbane me nr. 04-350/05-0069774/18, të datës 22.09.2018 të Kryetarit, që sipas nenit 3 të tij, ky vendim do të zbatohet në procedurën e caktimit të kushteve ndërtimore për zonat urbane të përfshira më dokumentet e planifikimit hapësinor dhe të definuara si zona urbane ndërtimore dhe atë në rastet kur a) ka mospërputhje në mes të dokumenteve të planifikimit hapësinor PRRU-së dhe PZhU-së, b) PRRU-të janë miratuar para miratimit të Planit Zhvillimor Urban, dhe neni 4 I cili I elaboron rastet përjashtuese kur ky vendim nuk aplikohet si në rastet a) Planet Rregulluese Urbanistike/ të ollësishme në fuqi, të miratuara pas hyrjes në fuqi të PZhU-së.

11. Rrjedhimisht, Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës duke u bazuar në arsyetimin e mësipërm, pikën 5 paragrafin 5.1, të pjesës tekstuale të PZhK, Planit Rregullues “Prishtina e Re- Zona Lindje”, Vendimit për përcaktimin e mënyrës së zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor në zonat urbane me nr.04-350/05-0069774, të datës 22.09.2018, ka konstatuar se Plani Rregullues “Prishtina e Re, Zona Lindje” është në fuqi dhe sipas këtij plani kjo zonë është paraparë të jetë zonë e gjelbërt, andaj nuk mund të zbatohen Kushtet Ndërtimore për zonën në fjalë, dhe si të tillë, Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës për herën e dytë e ka refuzuar kërkesën e parashtruar nga z.Rrahim Haradini.
12. Rrjedhimisht, argumenti i parë i prezantuar nga Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës është që për faktin që sipërfaqja për të cilën është kërkuar të lëshohen kushtet ndërtimore është më e madhe se 2 ha, atëherë vlen Planit Rregullues “Prishtina e Re, Zona Lindje” i miratuar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës me Vendimin 01 nr. 034-186833, me datë 02.10.2013, dhe sipas këtij plani kjo zonë është paraparë të jetë zonë e gjelbërt, vendim ky i miratuar pas PZhK, me Vendimin 01 nr. 031-156871, me datë 27.07.2013. Për më tepër, Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës e bazon këtë formë të interpretimit në vendimin e Kryetarit të kësaj komune për përcaktimin e mënyrës së zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor në zonat urbane me nr. 04-350/05-0069774/18, të datës 22.09.2018. Andaj, Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës ka konstatuar se Plani Rregullues “Prishtina e Re, Zona Lindje” është në fuqi dhe sipas këtij plani kjo zonë është paraparë të jetë zonë e gjelbërt, andaj nuk mund të zbatohen Kushtet Ndërtimore për zonën në fjalë.

IV. Vendimi i dytë i MMPH-së ndaj ankesës së z. Rrahim Haradini ndaj Vendimit të Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës

13. Me datë 27.06.2019, Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së duke vepruar sipas ankesës së z. Rrahman Haradini kundër Vendimit të datës 24.09.2018 të Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës, për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave materiale, poashtu mos zbatimit të PZhK-së dhe të Vendimit të Qeverisë nr. 16/127, të datës 24.02.2013 sipas të cilit Komuna nuk e ka zbatuar mirë meqë i njëjti konsideron se nëse Komuna i konsideron objektet e banimit “në kuadër të objekteve tjera apo si ndotës” atëherë, Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës, është dashur të kërkojë edhe pëlqimin mjedisor ndërsa projekti parasheh që ujërat e zeza të trajtohen me impiant biologjik, duke i propozuar MMPH-se, që ankesa të aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht, Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së merr vendim për shfuqizimin e vendimit të datës 24.02.2019 të Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës dhe e detyron të njëjtën të veprojë sipas Planit Zhvillimor Komunal, Vendimit nr. 16/127, të datës

24.02.2013 të Qeverisë së Kosovës për “Për caktimin e zonave të mbrojtura të burimit ujor për rreth Liqenit të Badovcit” dhe Ligjit nr. 04/L-110 për Ndërtim.

14. Sipas Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës nuk ka vendosur drejtë lidhur me kërkesën e palës sepse sipas PZhK, parcelat kadastrale nr. 603-2, 603-3 janë të parapara për ndërtim, kurse parcelat nr. 578-2, në kanalin ekologjik dhe një pjesë përfshihet për ndërtim dhe jashtë ndërtimit, kurse parcela nr. 574-4 në gjelbërim, parcela nr. 574-2 dhe 574-3 brenda kufirit të pejsazhit të mbrojtur, dhe prandaj kur Komuna ka refuzuar kërkesën e palës duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 4 nënparagrafi 4.2 të Vendimit të Qeverisë nr. 16/127, për arsye se parcelat hyjnë në “Zonën II – zonë e mbrojtur e regjimit të kufizuar” ku sipas nënparagrafit 4.2 të këtij vendimi shprehimisht thuhet: “Ndërtimi i objektit për turizëm ose rekreacion dhe objekteve tjera të cilat mund të rrezikojnë cilësinë e ujit”. Andaj, sipas Komunës, objektet – shëpitë e banimit, pa asjë konstatim I konsideron si të rrezikshme për ndotjen e ujit, ku e njëjta drejtori duhet të marrë parasysh se Zona II-të, si zonë e mbrojtur e regjimit të kufizuar nuk bën pjesë në kategorinë e regjimit të rreptë të ndërtimit në tërësi si, si zonë e mbrojtur e regjimit të kufizuar nuk bën pjesë në kategorinë e regjimit të rreptë të ndërtimit në tërësi siç e parasheh Zona I-rë, që I përket regjimit të rreptë, dhe e njëjta është dashtë të bëjë klasifikimin e objekteve të rrezikshme për ndotje siç janë: pompa vbenzinës apo ndonjë fabrikë, etj., por në këtë çështje administrative bëhet fjalë për ndërtimin e shtëpive banimore.
15. Së dyti, Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së ka konstatuar se Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës ka vepruar në kundërshtim me nenin 13 paragrafin 8 të Vendimit të Qeverisë, ku shprehimisht thuhet “Investitori nuk mund të marrë leje për ndërtim apo nuk mund të fillojë realizimin e ndonjë projekti, pa u pajisur, sipas Ligjit, me Pëlqim Mjedisor ose me Autorizim Mjedisor nga MMPH-ja”, andaj në dosje mungon Pëlqimi Mjedisor i cili nuk është kërkuar nga pala, pasi që Pëlqimi Mjedisor i përcakton të gjitha kriteret mbi lejimin apo ndalimin e ndërtimit, poashtu pala ka deponuar edhe projektin konceptua për trajtimin e ujërave të zeza përmes implianteve biologjike. Për më tepër, sipas Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, mosdhënia e arsyetimeve për faktet e rëndësishme lidhur me vendosjen e drejtë të kësaj çështje, vendimin e ankimuar e bënë të paqartë dhe të barazvlefshëm me mungësen e arsyetimit dhe është në kundërshtim me dispozitat e nenit 48 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Prandaj, ka detyruar Drejtorinë e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës që të veproj sipas PZhK-së për apcelat me nr. 603-2, 603-3 ZK Zllatar, Prishtinë që janë paraparë për ndërtim, kurse parcelat nr. 578-2, një pjesë e saj përfshihet për ndërtim, dhe sipas nenit 13 paragrafi 8 të vendimit të Qeverisë nr. 16/127, të marrë vendim të drejtë dhe të ligjshëm për këtë çështje administrative- juridike.

16. Rrjedhimisht, sipas Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, Komuna nuk e ka zbatuar në tërësi Vendimin e Qeverisë nr. 16/127, meqenëse nëse Komuna i konsideron objektet e banimit “në kuadër të objekteve tjera apo si ndotës” atëherë, Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës, është dashur të kërkoj edhe pëlqimin mjedisor, akt që lëshohet nga MMPH-ja, dhe akt që nuk është kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës gjatë procedimit të kësaj kërkesë. Kjo ngase, Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së prapë është thirrur në Planin Zhvillimor Komunal i cili parasheh se parcelat kadastrale nr. 603-2, 603-3 janë të parapara për ndërtim, kurse parcela nr. 578-2, në kanalin ekologjik dhe një pjesë përfshihet për ndërtim dhe jashtë ndërtimit, kurse parcela nr. 574-4 në gjelbërim, parcela nr. 574-2 dhe 574-3 brenda kufirit të pejsazhit të mbrojtur. Prandaj, sipas Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së kur Komuna ka refuzuar kërkesën e palës duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 4 nënparagrafi 4.2 të Vendimit të Qeverisë nr. 16/127, për arsye se parcelat hyjnë në “Zonën II – zonë e mbrojtur e regjimit të kufizuar” nuk ka marrë parasysh aktin ndjekës që kërkohet pas lëshimit të kushteve të ndërtimit, e që është kërkesën që duhet bërë për dhënien e Pëlqimit Mjedisor nga ana e MMPH-së. Rrjedhimisht, sipas Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës, pa asnjë konstatim i ka konsideruar si të rrezikshme këto objekte e që sipas MMPH-së, i takon këtij institucioni ta bëjë këtë vlerësim meqenëse është institucioni që e lëshon Pëlqimin Mjedisor. Pra, Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së e ka anuluar vendimin e Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës sepse i njejtë është marrë si vendim refuzues pa e dërguar pala kërkesën për dhënien e Pëlqimit Mjedisor, procedurë kjo që do të involvonte MMPH-në si organi kompetent për lëshim ose jo të këtij pëlqimi, por që është procedurë që zbatohet vetëm pas dhënies së kushteve për ndërtim, që sipas Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës do të ishin në shkelje të Vendimit të Qeverisë nr. 16/127.

V. Vendimi i tretë i Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës për caktimin e kushteve ndërtimore

17. Me datë 20.12.2019, Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës duke vepruar në kuadër të vendimit të datës 27.06.2019, të Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së merr vendim për caktimin e kushteve ndërtimore për pronarin Rrahim Haradini, sipas kërkesës së datës 05.09.2017, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin e 17 shtëpive individuale të banimit, në kuadër të parcelave kadastrale me nr. 578-2, 603-3, 603-2, 603-5, 603-6, ZK Zllatar.

18. Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës argumenton që në bazë të vendimit me nr. A-76/19, të datës 27.06.2019, të lëshuar nga Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së dhe Vendimit të Qeverisë me nr. 16/127 për caktimin e zonave të mbrojtura dhe masat e tyre mbrojtëse të burimit ujor sipërfaqësor-Akumulimi i Badovcit, kërkohet që para aplikimit për leje ndërtimore pala të pajiset me Pëlqim Mjedisor ose Autorizim Mjedisor nga MMPH-ja, pëlqim me të cilin përcaktohen të gjitha kriteret mbi lejimin apo ndalimin e ndërtimit. Kriteret e përcaktuara me Pëlqim Mjedisor ose Autorizim Mjedisor nga MMPH-ja janë pjesë përbërëse e pikës IV (kushteve ndërtimore). Në rast të mos sigurimit të Pëlqimit Mjedisor ose Autorizim Mjedisor nga MMPH-ja, kushtet ndërtimore pushojnë së vlejture. Për më tepër, Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës ka përcaktuar se kushtet ndërtimore për ndërmarrjen e veprimeve procedurale-administrative, fillojnë së vlejture vetëm pas sigurimit të Pëlqimit Mjedisor.
19. Rrjedhimisht, Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës duke vepruar në bazë të detyrimit ligjor hierarkik nga Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, lëshon kushtet ndërtimore të kërkuara në bazë të kërkesës së z. Rrahim Haradini dhe njëkohësisht specifikon që pa marrjen e Pëlqimit Mjedisor, akt ky që lëshohet nga MMPH-ja, të njejtat kushte nuk vlejné. Pra, vetëm në vendimin e tretë me rradhë të Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës, e njejtë ka vepruar sipas urdhërit të Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, i cili ka obliguar të procedohet me çështjen ashtuqë të lëshohen kushtet e ndërtimit për zonën në fjalë.

Analiza ligjore e rastit

20. Për të analizuar të gjitha veprimet e Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës dhe Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, së pari duhet sqaruar këto rrethana. Për sipërfaqen për të cilën është kërkuar lëshimi i kushteve ndërtimore ekziston Plani Zhvillimor Komunal i cili disa nga parcelat për të cilat është kërkuar të lëshohen kushtet ndërtimore të punës janë të parapara si zona për ndërtim, dhe njëkohësisht ekziston dhe Plani Rregullues “Prishtina e Re-Zona Lindje” sipas të cilit kjo zonë është e paraparë për gjelbrim. Për më tepër, për zonën për të cilën është kërkuar të lëshohen kushtet ndërtimore ekziston edhe një Vendim i Qeverisë nr. 16/127 për caktimin e zonave të mbrojtura dhe masat e tyre mbrojtëse të burimit ujor sipërfaqësor-Akumulimi i Badovcit i cili shpall liqenin e Badovcit si zonë të mbrojtur duke e ndarë atë në tri kategori zonash. E para është Zona e I-rë që klasifikohet si Zonë e mbrojtjes së regjimit të rrept, Zona e II-të e cila klasifikohet si Zonë e mbrojtjes së regjimit të kufizuar dhe Zona e III-të si Zonë e mbrojtjes së regjimit të lehtë. Një pjesë e parcelave për të cilat është kërkuar të lëshohen kushtet ndërtimore bijnë në Zonën e II-të, e cila në njërin prej pikave të përshkrimit të saj ndalon ndërtimin e çdo objekti turistik, për rekreacion ose objekte të

tjera të cilat do të mund të rrezikonin cilësinë e ujit. Rrjedhimisht, për të evituar ndërtimin e këtyre objekteve në këtë sipërfaqe si kriter tjetër që është vendosur pos kushteve të ndërtimit është edhe kriteri i marrjes së aktit të Pëlqimit Mjedisor i cili lëshohet nga MMPH-ja. Nëse investitorit i lëshohen kushtet e ndërtimit dhe i njejti siguron dhe Pëlqimin Mjedisor nga MMPH-ja atëherë mund të aplikojë për leje të ndërtimit.

21. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh faktet e paraqitura më lartë Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës me të drejtë ka vendosur që si bazë ligjore për marrjen e vendimeve të saj të përdor Vendimin e Qeverisë nr. 16/127, i cili ndalon çfarëdo ndërtimi të objektit që mund të ndikojë në cilësinë e ujit. I njejti institucion ka vendosur që ky vendim ka fuqi juridike më të madhe se Plani Zhvillimor Komunal meqenëse ky i fundit nuk është hartuar në pajtim me vendimin e qeverisë në fjalë. Për më tepër, Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës duke shmangur çfarëdo lloj situate që do të mund të krijohej me rastin e lëshimit të kushteve të ndërtimit dhe duke tentuar të respektojë Vendimin e Qeverisë nr. 16/127, ka refuzuar dy herë kërkesën e z. Rrahim Haradini meqenëse ka konstatuar që plani për ndërtimin e shtëpive individuale i bie të ndërtohet mbi zonën e mbrojtur me këtë vendim. Dhe që në këtë rast, edhe nëse e njejta do të lëshonte kushtet ndërtimore, Pëlqimi Mjedisor nuk do të duhej të lëshohej nga ana e MMPH-së meqenëse realizimi i planit ndërtimor të z. Rrahim Haradini do të dëmtonte rëndë cilësinë e ujit në akumulimin e Badovcit dhe rrjedhimisht çfarëdo akti i tillë do të ishte joligjor.
22. Nga kjo që u tha më lartë, vijmë në përfundim që Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, më saktësisht Sekretari i Përgjithshëm i MMPH-së, z.Arben Çitaku, kundërligjshëm ka detyruar/obliguar Drejtorinë e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës që të procedoi kërkesën për kushtet ndërtimore duke u thirrur gabimisht në nenin 20 dhe 21 të Ligjit për Ndërtim. Kjo ngase i njejti ka detyruar/obliguar Drejtorinë e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës që të veproj duke anashkuar vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 16/127, datë 24.04.2013, i cili shprehimisht, në nenin 11, par.4, nënpar. 4.3, zonën në të cilën kërkohet lëshimi i kushteve të ndërtimit e parashehet si zonë e ndaluar për ndërtim.
23. Së dyti, detyrimi i Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës nga ana e Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm MMPH-së që të procedojë me procedurën administrative për kushtet ndërtimore, sipas kërkesës së z. Rrahman Haradini, të datës 05.09.2017, është i kundërligjshëm për faktin se disa nga parcelat kadastrale të cilat permenden në kërkesë, hyjnë në zonën mbrojtëse të liqenit akumulues-Badovcit dhe në çfarëdo lloj situate ndërtimi i çfarëdolloj objekti për turizëm, rekreacion ose objekte të tjera të cilat do të mund të rrezikonin cilësinë e ujit, nuk do të mund të lejohej dhe zgjatja e procedurave administrative deri në shterjen e të gjitha mjeteve juridiko-administrative do të duhej të dërgonte në rezultatin e njejtë, pra mos lejimin e ndërtimit të çfarëdo objekti që do të

mund të rrezikonin cilësinë e ujit. Kjo ngase një gjë e tillë është e përcaktuar në Vendimin e Qeverisë nr. 16/127, vendim ky që ka fuqi mbi të gjitha aktet tjera komunale dhe çdo institucion shtetër duhet të garantoj për zbatimin e tij.

24. Rrjedhimisht, Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës në dy vendimet e para ka refuzuar kërkesën për kushte ndërtimore, ndërsa në vendimin e tretë lidhur me këtë çështje, në arsyetimin e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore, datë 20.12.2019, i referohet vetëm vendimit detyrues të MMPH-së (27.06.2019), ku obligohet Komuna që të rifilloj procedurën administrative për rastin konkret. Njëkohësisht, e njejta specifikon detyrimin ligjor që rrjedh nga Vendimi i Qeverisë nr.16/127 që në zonën e mbrojtur nuk mund të ndërtohet asnjë objekt që do të mund të rrezikonte cilësinë e ujit. Kjo ngaqë realizimi i ndërtimit të kompleksit të shtëpive individuale të banimit, në atë zonë do të ndikonte negativisht në biodiversitetin, ndotje të ambientit, tokës ose ujit, e si rrjedhojë do të binte në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi, me theks të veçantë me Ligjin për Mjedisin dhe Vendimin e Qeverisë me nr.16/127.

25. Andaj, në këto rrethana, me veprimet e ndërmarrura nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, z. Arben Çitaku, ekziston dyshimi i bazuar se janë përmbushur të gjitha elementet e veprës penale *“Lejimi i kundërligjshëm i ndërtimit apo drejtimit të fabrikave dhe instalimeve që ndotin mjedisin”* e paraparë në Nenin 340, par.1, i cili parasheh që *“Kushdo që duke shkelur ligjin mbi mbrojtjen e mjedisit, lejon ndërtimin apo instalimin e fabrikës ose drejton apo menaxhon fabrikën ose instalimin në të cilën kryhet veprimtari e rrezikshme dhe me këtë rrezikon të shkaktojë vdekjen apo lëndimin e rëndë trupor të ndonjë personi, ndotë mjedisin, ajrin, tokën apo ujin ose shkakton dëm në shumë prej pesëmijë (5.000) Euro apo më shumë të kafshëve, bimëve ose pasurisë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër (4) vjet”,* lidhur me nenin 28, par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ku thuhet: *“Kushdo që me dashje ndërmerr veprime për kryerjen e veprës penale por vepra nuk është kryer ose elementet e veprës penale nuk janë realizuar, konsiderohet se ka tentuar të kryejë vepër penale”.*

26. Poashtu, meqenëse me vendimet e lëshuara nga po i njejti zyrtar, janë aprovuar të gjitha ankesat që pala ka bërë ndaj refuzimeve nga ana e Komunës, vërehet tentimi i tij që të ndërhyjë në një process për të cilin çfarëdo procedure që do të zbatohej, përfundimi do të ishte i njejtë. Dhe rrjedhimisht tendenca e tij për të treguar të kundërtën, si qëllim për t’a ç’orientuar palën që ka parashtruar kërkesë për lëshimin e kushteve ndërtimore, përmes dhënies së bazë joligjore në aprovimin e ankesave të z.Rahman Haradini, e poashtu edhe obligimi i Komunës që të merr hapa konkret në procedurë administrative për realizimin e projektit ndërtimor, në një zonë e cila është e ndaluar për ndërtim që nga data 24.04.2013, me vendim të Qeverisë së Kosovës, paraqet dyshim të bazuar mirë se z.Çitaku ka kryer veprën penale *“Mashtrimi”* nga neni 323, par.1 të Kodit Penal të Kosovës.

27. Tutje, lidhur më këtë rast, Sekretari i Përgjithshëm i MMPH-së, z.Arben Çitaku, duke e shfrytëzuar pozitën e tij zyrtare dhe me dyshimin se i njehti ka pasur për qëllim që t'i shkaktojë dëm personit tjetër ose që t'i shkel të drejtat e personit tjetër, në këtë rast duke dëmtuar zonën e mbrojtur –Liqenin akumulues të Badovcit, ka nxjerrur vendime më të cilat i'a ka imponuar Drejtorisë së Urbanizmit të Komunës së Prishtinës, që edhe pas dy refuzimeve, t'ia aprovoi kërkesën z.Rahman Haradinit për lëshimin e kushteve të ndërtimit. Prandaj, ekziston dyshimi se z.Arben Çitaku me këto veprime ka konsumuar elementet e veprës penale *“Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 414, par.1, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.*
28. Përveç pjesës së lartëcekur, veprimet e ndërmarrura nga Sekretari i Përgjithshëm i MMPH-së, z.Arben Çitaku, bien në kundërshtim edhe me dispozitat e Ligjit për Ujërat e Kosovës, përkatësisht në nenin 26 paragrafi 2, ku ndalohet kryerja e të gjitha punëve të cilat shkaktojnë ndryshimin në gjendjen ujore. Poashtu, në nenin 66 të këtij ligji, përcaktohet mbrojtja dhe ruajtja e zonave të mbrojtura ujore, ku në këtë grup bën pjesë edhe Liqeni akumulues i Badovcit, i shpallur me vendimim e Qeverisë nr.16/127. Njëkohësisht, me të njëjtin ligj, në nenin 67 përcaktohet se në rastet *kur mund të rrezikohen kushtet cilësore apo sasiore, në zonën e mbrojtur ujore, mund të ndalohen ose kufizohen aktivitetet e pronarëve apo poseduesve të tokës*, situatë kjo që i përshtatet rastit konkret.
29. Më tutje, edhe Ligji për Mjedisin, në nenin 8, përcakton se *shfrytëzimi dhe mbrojtja e resurseve natyrore bëhet përmes planifikimit për ruajtjen e cilësisë dhe llojllojshmërisë së tyre, në përputhje me kushtet dhe masat për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara me këtë ligj dhe ligjet e veçanta.* Rrjedhimisht, ky ligj vendos kritere dhe kushte të cilat duhet të respektohen në çfarëdo situatë në çdo rast kur rrezikohet mjedisi, gjë e cila është tentuar të injorohet me veprimet e ndërmarrura nga Sekretari i Përgjithshëm i MMPH-së, z.Arben Çitaku, përmes vendimeve të drejtuara drejtë Drejtorisë së Urbanizmit të Komunës së Prishtinës.
30. Rrjedhimisht bazuar në veprimet e Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, z.Arben Çitaku, nuk janë marrë parasysh as dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr.15/2017 të datës 08.12.2017, për kriteret për përcaktimin e zonave të mbrojtura sanitare të burimeve të ujit. Me veprimet e tij, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, z. Arben Çitaku, ka rënë në kundërshtim me dispozita e nenit 4 ku thuhet se përcaktimi i zonave të mbrojtura sanitare bëhet me qëllim që të mbrohen burimet e ujit nga ndotja e qëllimshme apo e rastësishme e cila mund të ketë efekte negative në kapacitetet dhe vetitë natyrore të burimeve të ujit. Kjo duke pasur parasysh edhe faktin se në nenin 18, par.1, i po këtij Udhëzimi Administrativ përcakton se Zona e II-të sanitare përfshinë kufirin prej 500 (pesëqind) metra nga vepra ujëmarrëse. Kjo nënkupton që brenda kësaj hapësire, ashtu edhe siç e parasheh Vendimi i Qeverisë

nr.16/127, si dhe aktet ligjore në fuqi, ndalohet çdo lloj ndërtimi i objekteve, e aq me pak i atyre objekteve me karakter rekreativ apo të banimit sepse të njëjta do të mund të ndikojnë negativisht në biodiversitetin e florës dhe faunës, cilësinë e ujit etj. Shprehimisht këtë ndalesë e përmban edhe neni 13, paragrafi 1.10 lidhur me nenin 15 të këtij Udhëzimi Administrativ, kjo për shkak se ekziston rreziku se me ndërmarrjen e veprimeve të tilla mund të ketë pasoja në burimin e ujit, qoftë në kuptim sasior apo cilësor.

31. Prandaj, pasiqë në veprimet e z.Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së, ekzistojnë të gjitha elementet e veprave penale të lartëcekura si: *“Lejimi i kundërligjshëm i ndërtimit apo drejtimit të fabrikave dhe instalimeve që ndotin mjedisin”* e paraparë në *Nenin 340, par.1*, lidhur me nenin 28, par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës; *“Mashtrimi”* nga neni 323, par.1 të Kodit Penal të Kosovës; *“Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”* nga neni 414, par.1, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, dhe eventualisht të ndonjë vepre tjetër penale, e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, kërkojmë nga Prokuroria Themelore e Prishtinës që këtë çështje ta hetoj tërësisht dhe ta procedojë më tutje.

Me respekt,

Arbëresha Loxha, Drejtoreshë Ekzekutive në Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS)

Visar Azemi, Drejtor Ekzekutiv në Balkan Green Foundation Prishtina (BGF)

Burim Ejupi, Drejtor Ekzekutiv në Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)

Nora Latifi, Drejtoreshë Ekzekutive në Instituti për Studime të Avancuara (GAP)